



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT**

**SHPLLJE PËR EKSPERT/KËSHILLTAR
PËR KRYERJEN E PROCESIT TË REFLEKTIMIT DHE PËRDITËSIMIT TË
AKTEVE THEMELORE NËNLIGJORE TË AUTORITETIT PËR INFORMI, NË
KUADËR TË NDRYSHIMEVE TË REJA LIGJORE TË LIGJIT 45/2015, ME LIGJIN
NR. 72, DATË 20.10.2022**

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit

Në mbështetje të Ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” (i ndryshuar), Neni 36, pika 6 “Autoriteti për realizimin e veprimtarisë sipas këtij ligji, ka të drejtë të përzgjedhë dhe të kontraktojë ekspertë të jashtëm”, të Vendimit të Autoritetit për Informim me nr. 424 datë 27/09/2022, me objekt “Për procedurën që do të ndiqet për kontraktimin e mdhe VKM nr. 187, datë 8.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”,

shpall Procedurat për kontraktimin e një eksperti/këshilltari për kryerjen e procesit të reflektimit dhe përditësimit (ndryshimeve shtesave) të akteve themelore nënligjore të Autoritetit për Informim, në kuadër të ndryshimeve të reja ligjore të Ligjit 45/2015, me ligjin Nr. 72, datë 20.10.2022:

- **Kategoria e pagës III-a.**

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

1/02/2023

1- Detyrat dhe përgjegjësitë:

I mbështetur nga ekipi i Autoritetit, eksperti këshillues:

- Do të përgatisë dokumentin e zgjeruar dhe të përmbledhur që paraqet qëllimin

e tryezës së diskutimeve, temat kryesore dhe produktet e saj.

- Të hartojë një dokument për hapat paraprakë të organizimit dhe të mbështesë Autoritetin gjatë tryezës së diskutimeve, përfshirë përgatitjen e pikave të diskutimit dhe udhëzimet për AIDSSH.

- Të hartojë një dokumente, ku identifikohen pikat kryesore të cilat pritet të
- Hartimi i akteve nënligjorë të funksionimit të Autoritetit për Informim, të bazuar në ligjet në fuqi dhe vecanërisht në Ligjin 45/2015, të ndryshuar.
- Të kryejë detyra të tjera të kërkuara nga Kryetari/ja e Autoritetit.

Rezultatet e pritshme

Rezultatet e pritshme:

- Draftim i akteve themelore të autoritetit në kuadër të ndryshimeve ligjore të ligjit funksional të Autoritetit me nr. 45/2015, i ndryshuar;
- Një raport përfundimtar ku përshkruhet puna e ekspertit, produktet, përfshirë rekomandimet të shoqëruara me draft aktet përkatëse.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master” në fushën e jurisprudencës, të drejtës ndërkombëtare, komunikimit dhe shkencave humane (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi, si dhe e preferueshme është të ketë titull shkencor*)
- Të kenë të paktën 10 vjet përvojë pune.
- Të kenë eksperiencë pune konkrete në fushën e kërkimit, të drejtave të njeriut, përpunimit të strategjive, hartimit të materialeve udhëzuese, komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun;
- Të zotërojnë gjuhën angleze, të folur e të shkruar dhe të prezantimit në shqip dhe anglisht. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.
- Të plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit 12 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- Të ketë eksperiencë të mëparshme të ngjashme;
- Të ketë aftësi të pëlqyeshme komunikuese;
- Të ketë aftësi për të krijuar një mjedis bashkëpunimi dhe bashkëveprimi.

2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur;
- b- Jetëshkrim i plotësuar;
- c- Fotokopje të diplomës së masterit;
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- h- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 1/02/2023.

3. NJOHURITË MBI LEGJISLACIONIN TË CILAT DUHET TË KETË KANDIDATI:

Njohuritë mbi legjislacionin të cilat duhet të ketë kandidati:

- a) Njohuri mbi Ligjin Nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të RPSSH”;
- b) Njohuri mbi Ligjin Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, i ndryshuar;
- c) Njohuri Mbi Ligjin Nr. 9887, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
- e) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- f) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- g) Njohuritë mbi Ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- h) Njohuri mbi Ligjin Nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”;

4. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

5. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të Autoritetit, <http://autoritetidosjeve.gov.al/>. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.